



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 809/2 prot.

Tiranë, më 16. 06. 2022

V E N D I M

Nr. 122, datë 16. 06. 2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 89, datë 02.06.2022, e M. D. kundër Bashkisë Mat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të *“bindjes politike”¹*.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: *“Unë paditësi M. D., i datëlindjes 11.06.1963, me arsim të lartë, Dega "Agronomi e Përgjithshme", më datë 19.06.2017 jam emëruar "Specialist i Kadastrës së Tokës Bujqësore" në Njësinë Administrative Rukaj, me status "Nënpunës Civil".*

Në muajin shkurt 2018, ndjek kursin e trajnimit të detyrueshëm për Nëpunësit Civil dhe vlerësohem e çertifikohem në provimin përfundimtar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, më datë 06.03.2018.

Më datë 08.07.2020 me anë të vendimit nr. 470, njoftohem nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njërëzore pranë Bashkisë Mat, për transferim të përkohshëm për shkak të nevojave të institucionit për të mbuluar përkohësisht me një punonjës me përvojë, pozicionin e Specialistit të Kadastrës së Tokës Bujqësore, në Njësinë Administrative Lis.

Referuar sa më sipër, ky transferim ishte i vlefshëm deri më datë 13.10.2021 dhe pas kësaj date jam rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës si "Specialist i Kadastrës së Tokës Bujqësore" në Njësinë Administrative Rukaj.

Dhe pse nuk isha dakord me sa mësipër, ndodhur në këto kushte, vijova normalisht detyrën time si Specialist i Kadastrës së Tokës Bujqësore, pranë Njesisë Administrative Lis, për

¹ Referuar Vërtetimit datë 10.06.2022 të lëshuar nga Partia Demokratike, M. D. është anëtar i subjektit politik: Partia Demokratike e Shqipërisë, prej vitit 1991 e në vijim. Gjithashtu, M. D. në vitet 1992-1996 ka qenë Kryetar i Komunës Rukaj si përfaqësues i Partisë Demokratike.

periudhën e caktuar, për shkak se nuk kisha burime të tjera jetese dhe mundësi punësimi, si dhe për shkak se ky transferim ishte i përkohshëm dhe njëkohësisht nuk doja të humbisja statusin e nëpunësit civil...

Transferimi im ishte politik pasi nuk ishte aspak në shërbim të punës sonë dhe të komunitetit. Bashkia vetëm sa ndryshojë vendet e punës me shtetasen D. K.... Pra, siç po theksoj Bashkia diskriminimin politik e ka nisur që në Korrik 2020, por ndoshta reagimi i kolegëve e stepi Bashkinë për të vazhduar më tej.

Në datë 09.05.2022 njoftohem me anë të vendimit nr. 316 për "Lirimin nga Shërbimi Civil", për shkak të ristrukturimit të Bashkisë Mat, duke mu propozuar vijimi i marrëdhënieve të punës bazuar në Kodin e Punës.

Lirimi im nga Shërbimi Civil, nuk është bërë për shkak të ristrukturimit të Institucionit, pasi ky institucion vijon të ketë pozicione të shërbimit civil të të njëjtit nivel me atë që unë kam ushtruar dhe fituar statusin në shërbimin civil dhe që përshkatan arsimin tim.

Lirimi im nga shërbimi civil, nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, është bërë në kundërshtim të hapur me ligjin 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" dhe VKM nr. 124 datë 17.02.2016. Kjo shkelje e hapur e ligjit dhe e akteve nënligjore konsiston në mosrespektimin e procedurave ligjore të parashikuara për rastet e transferimit si dhe të lirit nga shërbimi civil si dhe në shkeljen flagrante të kushtit ligjor ndalues të përcaktuar në pikën 6 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij...".

Sa më sipër, ankuesi nuk ka pranuar të vijojë marrëdhëniet e punës me Bashkinë Mat në një pozicion pune i cili rregullohet me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, por të emërohen në një pozicion pune me status të nëpunësit civil.

Në përfundim, ankuesi pretendon se është diskriminuar nga ana e Bashkisë Mat, për shkak të bindjeve politike, pasi është anëtarë i Partisë Demokratike që nga viti 1991 deri më sot. Gjithashtu, për shkak të faktit që vjen nga një familje të persekutuarish politik, pasi gjyshi i tij N. A. D. ka qenë i dënuar me 25 vjet burg politik, në vitin 1946.

Përsa më sipërcituar, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike dhe faktit që vjen nga një familje të persekutuarish politik, si dhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, përcaktohet se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".

Diskriminimi përkufizohet nga ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar², në nenin 3/1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohej nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Në informacionin e dërguar me anë të e-mail-it datë 13.06.2022, subjekti ankues ka bashkëlidhur dhe kopje të dokumentacionit poshtëcitur:

- Kërkesë Padi kundër Bashkisë Mat, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, regjistruar më datë 10.06.2022, me objekt: *“Shfuqizimin e vendimit Nr. 316, datë 09.05.2022 për "Lirimin nga shërbimi civil të nëpunësit civil M. D., për shkak të ristrukturimit të Bashkisë Mat", si një vendim i marrë në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi; Rikthimin e paditësit në vendin e mëparshëm të punës apo në një pozicion të barasvlefshëm me të në shërbimin civil; Detyrimin e pagimit të pagës nga momenti i ndërprerjes e deri në rikthimin në vendin e mëparshëm të punës apo në një vend të barasvlefshëm me të; Detyrimin e palës së paditur për pagimin e shpenzimeve gjyqësore.”*.

Në parashtrimet e tij në kërkesë padi, ankuesi në mes të tjerash ka pretenduar se është larguar në mënyrë të paligjshme dhe duke u diskriminuar, duke cituar shprehimisht se: *“...E gjithë veprimtaria e palës së paditur ka patur si qëllim finalizimin e ndërprerjes në mënyrë të paligjshme të statusit tim si nëpunës civil duke shkaktuar pasoja të rënda për të drejtat e mia si nëpunës civil si dhe diskriminim, pasi lirimi nga shërbimi civil nuk është rrjedhojë e ristrukturimit në kuptim të ligjit.....”*.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të sjellë pranë Komisionerit, si dhe bazuar në kërkesë-padinë e ankuesit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të depozituar si provë pranë Komisionerit, rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues, për diskriminim, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se të njëjtat fakte, rrethana e shkaqe që janë paraqitur edhe përpara Komisionerit, janë bërë prezent në parashtrimet e paraqitura para Gjykatës, nga ana e ankuesit.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet: *“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme*

² Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë”.

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë janë një nga kategoritë e akteve me më ndikim në sistemin ligjor shqiptar dhe sidomos në praktikën gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese mundësohet interpretimi i njësuar i ligjit, duke sjellë si pasojë zbatimin e njësuar të tij në rastet konkrete gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese jo vetëm garantohet shteti ligjor si themel kushtetues i Republikës, por i jepet jetë parimit të sigurisë juridike.

Neni 141, i Kushtetutës shprehet se: “Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”. Pra, Kushtetuta shprehimisht i njeh të drejtën dhe detyrimin Gjykatës së Lartë, që përmes Kolegjeve të Bashkuara të unifikojë, ose më saktë, të “njësojë” praktikën gjyqësore. Kjo kompetencë e Gjykatës së Lartë detajohet në ligjin nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Në nenet 14, 16, 17 dhe 19 të të cilit parashikohet mënyra e ushtrimit të saj).

Ky Ligj, normon se: “Moszbatimi i vendimeve unifikuese, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave këto vendime janë të detyrueshme përbën shkelje të rëndë disiplinore”. Për rrjedhojë, të gjitha vendimet unifikuese janë të detyrueshme për gjykatat dhe moszbatimi i tyre sjell përgjegjësi disiplinore, me pasojë shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, do të pushonte çështjen nëse ajo do të ishte në shqyrtim e sipër. Pra, jemi në kushtet kur ankesa e paraqitur, është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

Bazuar në nenin 36/4, të ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë³, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 89, datë 02.06.2022, të paraqitur nga shtetasi M. D., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindjet politike dhe përkatësia në një grup të veçantë)
(Fusha: Punësim)

³ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.